

2024030756

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MBROJTJES SHËNDETËSORE

Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16 dhe 20/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 101/19, 153/19, 180/19, 275/19, 77/21, 122/21, 178/21, 150/22, 236/22, 199/23, 236/23 dhe 263/23), në nenin 70, pas paragrafit (3), shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

“(4) Poliklinika që zbaton veprimtari shëndetësore stomatologjike në dy ose më shumë ordianca, mund të zbatojë veprimtari në nivel primar në ordianca të nivelit primar dhe veprimtarisë specialistiko-konsultative në ordianca të nivelit sekondar (poliklinika stomatologjike në nivel primar dhe sekondar)”.

Neni 2

Në nenin 89 pas fjalëve: “barnat e dhëna” shtohen fjalët: “dhe jep informata dhe këshilla, si dhe kryen shërbime preventive dhe shërbime tjera lidhur me terapinë me barna”.

Neni 3

Në nenin 256, paragrafin (1), në pikën 3) lidhëza “dhe” zëvendësohet me pikëpresje dhe shtohet pika e re 4), si vijon:

“4) miraton akt për përcaktimin e çmimeve minimale të shërbimeve shëndetësore private, përkatësisht shërbimet të cilat pacientët i paguajnë me mjete personale;”.

Pika 4) bëhet pika 5).

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.